

Siguri

Ekskluzive | E kanosi me revole pas provokimeve në komunikacion, arrestohet 24-vjeçari në Obiliq – Policia i sekuestron armën



Sinjali.com

09 Korrik 2026 09:03



Një konflikt në komunikacion është përshkallëzuar në kanosje me armë zjarri, duke çuar në arrestimin e një 24-vjeçari dhe sekuestrimin e armës që ai posedonte në veturë, raporton Sinjali.

Burimet e Sinjalit bëjnë të ditur se rasti ka ndodhur më 8 korrik, rreth orës 12:50, në aksin rrugor nga Millosheva deri në Shkabaj, në territorin e komunës së Obiliqit.

Sipas denoncimit të viktimës, A. P. (38 vjeç), gjatë lëvizjes në komunikacion, drejtuesi i automjetit tjetër, Leonard Geci (24 vjeç), kishte kryer disa frenime të vrullshme dhe manovra provokuese. Më pas, sipas ankuesit, ai kishte nxjerrë dhe ekspozuar një revole, duke e kanosur.

Pas raportimit të rastit, automjeti i të dyshuarit është ndaluar nga njësitet policore të Stacionit Policor Jugu në Prishtinë, ndërsa më pas rasti është trajtuar nga Stacioni Policor në Obiliq, pasi ngjarja kishte ndodhur në territorin e tij.

Gjatë kontrollit të automjetit, Policia ka sekuestruar:

- një armë zjarri Zastava;
- një karikator;
- 9 fishekë;
- një leje për armë të shenjëtarisë;
- një libër për evidencën e lëvizjeve me armë.

Sipas burimeve të Sinjalit, ndonëse i dyshuari posedonte leje për armë të shenjëtarisë, arma dyshohet se është përdorur në kundërshtim me ligjin gjatë incidentit në komunikacion.

Leonard Geci është shoqëruar në Stacionin Policor në Obiliq, ku është intervistuar në prani të avokatit mbrojtës.

Me vendim të Prokurorit të Shtetit, ai është ndaluar për 48 orë, ndërsa ndaj tij është iniciuar procedurë për veprat penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” dhe “Kanosja”.

Rasti është duke u hetuar nga organet kompetente.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera